



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË**

Numri i lëndës: 2024:131719  
Datë: 08.05.2024  
Numri i dokumentit: 05666747

**PPP.nr.5/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Artan Abazi dhe bashkëpunëtorin profesional Blerand Sopi, duke vendosur lidhur me çështjen përmbartimore të Kreditorit “ProCredit Bank” me seli në Gjilan, ndaj debitorëve I. D., E. D., V. D., P. A., që të tre nga ....., lidhur me lirimin dhe zbrapsjen e paluajtshmërisë së hipotekuar, jashtë seancës gjyqësore, më datën 07.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I.** Procedura në këtë çështje përmbartimore **NDËRPRITET** për shkak të çështjes paraprake, respektivisht deri sa të përfundojë me vendim të formës së prerë, procedura penale ndaj tani të pandehurit - debitorit I. D. nga .....

**II.** Procedura e ndërprerë do të vazhdojë pasi që të krijohen kushtet ligjore, me kërkesën e palëve ndërgjyqëse apo kur të njëjtit i thërret gjykata.

**A r s y e t i m**

Lidhur me këtë çështje përmbartimore në mes të kreditorit “Procredit Bank” me seli në Gjilan, si kreditor dhe I. D., E. D., V. D., P.A., që të tre nga ....., si debitor, është zbatuar përmbartimi, dhe parcelat hipotekuese me numër P-71107040-01816-0, P-71107040-01861-0 dhe P-71107040-01863-0 në sipërfaqe prej 8316 m<sup>2</sup> të cilat gjenden në Zona Kadastrale Koretin, me konkluzionin me numër 074/14 të datës 23.04.2015 i janë shitur kreditorit Procredit Bank.

Me datë 26.09.2018 Përmbartuesi Privat Sefer Arifi duke vepruar sipas propozimit të Kreditorit, ka nxjerrë konkluzion për lirimin dhe zbrapsjen nga sendet dhe njerëzit të paluatshmërive të

lartëcekura, dhe Sh. I. D. përmes përfaqësuesit të tij Besim Osmani me datë 08.10.2018 ka bërë kërkesë për mosekzeutimin e konkluzionit me arsyetimin se lidhur me këtë çështje ka paraqitur padi për anulimin e kontratave të kredisë e cila evidentohet me numër C.nr.85/2018 dhe dëmi i cili do ti shkaktohej paditësit në rast se vendoset lidhur me lirimin dhe zbrapsjen nga njerëzit dhe sendet do të ishte i madh dhe i parekuprueshëm.

Me datë 19.02.2020, përfaqësuesi i të dëmtuarit - personit të tretë A.D., Av.Selami Rexhepi ka paraqitur kërkesë pranë përbaruesit privat Sefer Arifi me të cilën ka kërkuar tërheqjen e urdhërit përbarimor P/-74/14, ndërsa me datë 24.02.2020 pranë Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, ka paraqitur kërkesë për ndërprerjen e procedurës me arsyetimin se ngastrat e lartëcekura asnjëherë nuk kanë qenë pronë e kredimarrësit I. D..

Gjykata, përmes administratës të kësaj Gjykate, është njoftuar se ndaj debitorit tani të pandehurit I. D. nga babai Sh. dhe nëna S. i lindur me datë ..... në ..... ku edhe jeton, ma datë 18.12.2023 është ngritur Aktakuzë e cila evidentohet me numrin PP.II.nr.893/2023, dhe e njejta është në procedim e sipër në Gjykatën Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, e cila evidentohet me numrin P.nr.198/2023 (2023:213983) për veprën penale të Mashtrimit nga neni 323 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 7 të KPRK-së, ku i njejti akuzohet se me veprime të kundërligjshme përkatësisht mashtrimit, ngastrat të cilat edhe janë objekt i kësaj çështje përbarimore, dhe atë P-71107040-01816-0, P-71107040-01861-0 dhe P-71107040-01863-0 në sipërfaqe prej 8316 m2 të evidentuara më herët në emër të babait të tani të dëmtuarve(persona të tretë) i ka vënë në hipotekë me qëllim të marrjes së kredisë në shumë prej 65,000.00 Euro në bankën Procredit Bank.

Duke i pasur parasysh faktet dhe provat e lartëcekura, gjykata vendosi që në këtë çështje përbarimore ta ndërpret procedurën, derisa çështja penale e lartëcekur të mer epilog, përkatësisht e njejta të përfundohet me vendim të plotfuqishëm të Gjykatës.

Gjykata përshtatshmërisht bazuar në nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore, zbatoi dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, dhe konform nenit 278 paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, duke marrë parasysh të lartëcekurat, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**  
**P.nr.5/2020 i datës 07.05.2024**

**G j y q t a r i**  
**Artan Abazi, d. v**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjës së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.